



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga Sokol Çomo kryesues, Albana Shtylla relatore, Ina Rama, Mimoza Tasi, Rezarta Schuetz anëtare, shpalli vendimin për çështjen nr. 17/2024, datë 21.05.2024, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 735, datë 31.01.2024, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi.

Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë unanime, vendosi:

Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 17/2024, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 735, datë 31.01.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Nushi.

^

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.12.2025, në Tiranë.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/))

< Njoftim vendimi (https://kpa.al/njoftim-vendimi-384/) Njoftim (https://kpa.al/njoftim-1647/) >

